


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7947
E shtunë, 7 dhjetor 2024
Çmimi 0.50

BE-ja: Serbia, hapa të pamjaftueshëm ndaj përgjegjësve për sulmet në veri të Kosovës

FAQET



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de


OPINION

HIJET E TURPIT TË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR?! F.5

Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ



AKTUALE



SHOIPËRIA DO T'I MBAJË ZGJEDHJET PARLAMENTARE MË 11 MAJ F.3

KURTI TAKOHET ME ANËTARËT E PRESIDENCËS SË BOSNJËS F.2

EKONOMI



KUVENDI I KOSOVËS MIRATOI TRI LIGJE KYÇE PËR ZHVILLIMIN FINANCIAR TË VENDIT F.8

RAPORTI I ASK-së: QEVERIA RRIITI SHPENZIMET KËTË VIT F.8

SPORT

SOT DY NDESHJE NË SUPERLIGË, DY TË TJERA NESËR F.10

KILAJ, SMAKAJ DHE FAZLIU DËRGOHEN NË HAGË

FAQET 4-5



Një ditë pas arrestimit nga Gjykata Speciale, ish-kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, ish-shefi i AKI-së, Bashkim Smakaj dhe ish-luftëtari i UÇK-së, Fadil Fazliu, janë

dërguar të premtën në qendrën e paraburgimit në Hagë. Ndaj arrestimit të tyre dhe procesit gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së ka pasur reagime të shumta, në mesin

e tyre edhe nga PDK-ja. Kjo parti ka kërkuar nga Gjykata Speciale paanshmëri dhe transparencë në procesin gjyqësor ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit

DY MUAJ PARA ZGJEDHJEVE, A ËSHTË GJITHÇKA GATI? F.3



SERBIA DËNON NEZIR MEHMETAJN ME 6 VJET BURGIM F.2



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Serbia dënon Nezir Mehmetajn me 6 vjet burgim

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Shtetasi i Kosovës, Nezir Mehmetaj, është dënuar nga Gjykata e Lartë e Serbisë me gjashtë vjet burgim, me akuzën për krime lufte kundër popullatës civile në fshatin Rudicë të Klinës më 1999. Ekipi i tij mbrojtës ka paralajmëruar se do ta apelojë këtë vendim.

Gjykata e Lartë e Serbisë tha se ka konstatuar se Mehmetaj në qershor të vitit 1999 kishte marrë pjesë në rrëmbimin e civilit me kombësi rome, Jelaj Ramadan, mbetjet mortore të të cilit ende nuk janë gjetur.

Sipas pretendimeve të gjykatës, bashkë me Mehmetajn kanë qenë edhe anëtarë të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Në vendimin e gjykatës u tha se Mehmetaj ishte pjesëtar i UÇK-së dhe në atë kohë lëvizte në fshatin Rudicë me uniformë të UÇK-së.

Në aktakuzën ndaj Mehmetajt thuhej se në mes të qershorit të vitit 1999 ai kishte marrë pjesë në vrasjen e pesë anëtarëve të familjes Dashiç dhe në fund të qershorit, kishte marrë pjesë në vrasjen e Jelaj Ramadanit dhe Zorka Shijakoviçit.

Gjykata e Lartë e Beogradit tha se nuk është dëshmuar pjesëmarrja e tij në vrasjen e anëtarëve të familjes Dashiç dhe Zorka Shijakoviçit, si dhe nuk është dëshmuar që Mehmetaj, në korrik të vitit 1999, kishte marrë pjesë në plaçkitjen dhe djegien e dhjetë shtëpive në fshat që u përkisnin joshqiptarëve.

Avokati i Nezir Mehmetajt, Milliq Konstantinoviç, tha për Radion Evropa e Lirë se do ta apelojë vendimin pasi, sipas tij, gjykata nuk ka prova relevante për asnjë pikë të aktakuzës. Ai tha se gjykata nuk i ka pranuar provat që janë paraqitur nga mbrojtja, e të cilat, sipas tij, tregojnë se Mehmetaj nuk ka qenë fare në Rudicë në kohën që përmendet në aktakuzë, por ka qenë në Zvicër.

Gjykata duket qartë se e ka bazuar vendimin në dëshminë e një dëshmitari të mbrojtur, i cili ka dhënë një deklaratë shumë të diskutueshme në Prokurori. Bëhet fjalë për një person që në kohën e këtyre ngjarjeve ishte 14 vjeç”, tha Konstantinoviç për Radion Evropa e Lirë.

Ai shtoi se gjatë gjykimit mbrojtja ka theksuar se Mehmetajt nuk mund t'i vihet barra për



veprimet që kanë ndodhur pas qershorit të vitit 1999, kur lufta kishte përfunduar.

Në dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë e gjyqësorit më 6 dhjetor, Mehmetajt do t'i llogaritet koha e qëndruar në paraburgim.

Nezir Mehmetaj u arrestua më 3 janar 2020 në pikëkalimin kufitar në Merdar dhe që atëherë është mbajtur në paraburgim.

Po atë vit autoritetet gjyqësore serbe ngritën aktakuzë ndaj tij për krime lufte në Rudicë të komunës së Klinës në periudhën qershor-korrik 1999.

Autoritetet e Kosovës vazhdimisht kanë kërkuar

lirimin e Mehmetajt dhe të disa qytetarëve të tjerë të Kosovës, që janë arrestuar nga Serbia për krime lufte.

Ministria e Drejtësisë e Kosovës në korrik të vitit 2024 kërkoi nga Serbia t'i ekstradojë në Kosovë shtetasit e Kosovës që mbahen atje.

Por, udhëheqësja e kësaj ministrie, Albulena Haxhiu, deklaroi se është e vështirë që Serbia t'i përgjigjet pozitivisht kësaj kërkesë, për shkak të mosbashkëpunimit të vazhdueshëm juridik.

Përveç Mehmetajt, në Serbi gjenden në paraburgim, me akuza për krime lufte, edhe

Hasan Dakaj dhe Tefik Mustafa. Ndërkaq, Sadiku Duraku, që ishte arrestuar më 17 prill, i dyshuar për krime lufte, është liruar në tetor të këtij viti.

Departamenti Amerikan i Shtetit ka bërë thirrje për proces të drejtë ligjor për personat e arrestuar në Serbi me akuzat për krime lufte.

Puna e Prokurorisë serbe është kritikuar në të kaluarën.

Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare në Serbi, mungesa e transparencës dhe mungesa e informacionit - që duhet të jetë i qasshëm publikisht - e kanë përjashtuar publikun prej këtyre proceseve.

Në raportin e fundit të kësaj organizate është përmendur edhe mungesa e dëshmitarëve. Sipas tij, Prokuroria nuk ka qenë në gjendje të sigurojë asnjë dëshmitar kyç për më shumë se dy vjet në rastet për krime lufte.

Në Raportin e Progresit për Serbinë, për vitin 2023, Komisioni Evropian ka përmendur që “ritmi i gjykimit të krimeve të luftës në Serbi është përkeqësuar në vitet e fundit” dhe se duhet treguar përkushtim të vërtetë për zgjidhjen e rasteve.

Kurti takohet me anëtarët e Presidencës së Bosnjës

SARAJEVË, 6 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është takuar me dy anëtarë të Presidencës trepalëshe të Bosnjë-Hercegovinës. Gjatë vizitës në Sarajevë ai zhvilloi takime të ndara në Presidencën e Bosnjës me anëtarin kroat Zheko Komshiq dhe atë boshnjak Denis Beqiroviç. “Falënderoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti, për vendimin për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës. Vlerësojmë një hap të tillë të jashtëzakonshëm të njëanshëm dhe, për këtë arsye, të pazakontë. Ky veprim sigurisht do të kontribuojë në lidhjen më të mirë të qytetarëve të Bosnjë-Hercegovinës dhe Kosovës, si dhe për rritjen e shkëmbimeve të ndërsjella tregtare”, ka shkruar Komshiq në “Facebook” pas takimit me Kurtin.

Kurti nisi vizitën në Sarajevë më 5 dhjetor dhe gjatë qëndrimit në Bosnjë do të mbajë edhe një fjalim në një konferencë për raportet rajonale që organizohet nga “Asociacioni i Intelektualëve të Pavarur Krug 99”.

Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova nuk e kanë njohur njëra-tjetrën për shkak të kundërshtimit të



Republikës Sërpska, në krye të së cilës është Millorad Dodik, i cili ka orientim prorus dhe është i sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara për minimin e Marrëveshjes së Dejtonit.

Vizita e Kurtit në Sarajevë është kundërshtuar nga kreu i entitetit të Republikës Sërpska, Millorad Dodik, i cili ka thënë se qëndrimi i kryeministrit të Kosovës në Bosnjë, do ta ndërlikojë situatën në këtë shtet. “Bosnjë-Hercegovina nuk e ka njohur

Kosovën. Ne nuk do të lejojmë që shqiptarët nga ai rajon të hyjnë me letërnjoftim”, tha Dodik, sipas raportimit të “Srnas”-it.

Për shkak të vizitës së Kurtit në Sarajevë, më 5 dhjetor ministrat nga Republika Sërpska thanë se nuk do të marrin pjesë në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës.

Kryeministri i Kosovës nuk zhvilloi takim me anëtarin serbe

të Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, kryesuesen Zhelka Cvijanoviç.

Komshiq tha se kritikata e pretenduara lidhur me vizitën e Kurtit dhe takimet që ai ka në Bosnjë-Hercegovinë, të cilat vijnë nga entiteti i Republikës Sërpska (RS), si dhe nga rajoni, “më kujtojnë se RS-ja nuk është subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe se RS-ja nuk ka kompetenca për lëshimin e vizave për hyrjen në Bosnjë-

Hercegovinë”.

Ai shtoi se kritikata që vijnë nga vendet e rajonit i konsiderojmë si një provë tjetër të qartë të përpjekjeve për ta mohuar sovranitetin e Bosnjë-Hercegovinës dhe si presion ndaj organeve dhe institucioneve sovrane të vendit tonë në udhëheqjen e politikës së jashtme. “Po ashtu, anëtarët e Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës sigurisht nuk do të pyesin as [udhëheqësin e serbëve në Bosnjë, Millorad] Dodikun, as këdo tjetër, se me kë do të takohemi dhe për çfarë do të diskutojmë”.

Kurti kishte deklaruar në mes të tetorit, gjatë samitit të Procesit të Berlinit, se Kosova nga 1 janari 2025 do t'i lejojë qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës të hyjnë me letërnjoftim.

Marrëveshja që do ta hiqte regjimin e vizave midis Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës dhe do t'u mundësonte qytetarëve të këtyre dy vendeve të udhëtojnë pa viza, ende nuk është ratifikuar në Kuvendin e Bosnjë-Hercegovinës. Ajo po bllokohet nga përfaqësuesit e Republikës Sërpska, të udhëhequr nga Lidhja e Socialdemokratëve të Pavarur e Millorad Dodikut.

Nënshkruhet memorandum ndërmjet ASK-së dhe UNICEF-it mbi anketën MICS 2025

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 DHJETOR - MICS është një nga anketat më të mëdha ndërkombëtare të ekonomive familjare në nivel global që gjeneron të dhëna me cilësi të lartë dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht, duke përfshirë 85 për qind të treguesve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) të lidhura me anketat e ekonomive familjare.

Për Kosovën, ky moment shënon raundin e tretë të realizimit të MICS-it, i cili bazohet në përfundimin e suksesshëm të dy anketave të mëparshme të realizuara në vitin 2014 dhe 2020. "ASK-ja falënderon UNICEF-in për mbështetjen teknike të ofruar si pjesë e programit MICS dhe presim angazhimin tonë të përbashkët për mbledhjen e të dhënave me cilësi të lartë, që do

të jenë jetike për t'i informuar politikant dhe programet në Kosovë", ka thënë Avni Kastrati, u. d. i drejtorit ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

MICS 2025 në Kosovë do t'i plotësojë boshllëqet kritike të të dhënave si dhe do të sigurojë vlerësime për monitorimin e progresit në fushën e shëndetit, edukimit dhe mbrojtjes së fëmijëve.

MICS do të gjenerojë të dhëna të hollësishme dhe të zbërthyer, si dhe do të mbledhë të dhëna specifike për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian për monitorimin e barazisë dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve dhe familjeve të grupeve të marginalizuara.

Mbledhja e të dhënave është planifikuar të fillojë në pranverën e vitit 2025, me rezultatet e anketimit që planifikohet të publikohen në



fund të vitit 2025.

Ngjashëm me raundet e mëparshme, ky MICS do të përbëhet nga dy anketa të veçanta: njëra që përfshin popullatën e përgjithshme, anketa tjetër përfaqësuese që ka për synim veçanërisht

komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian.

Anketat MICS të viteve 2014 dhe 2020 në Kosovë kanë qenë jetike për informimin e vendimeve dhe politikave dhe ndarjen e buxhetit, me qëllim të adresimit të sfidave kryesore me të cilat

përballen fëmijët dhe familjet në Kosovë. "UNICEF-i mirëpret bashkëpunimin me ASK-n për ta përmirësuar gjenerimin e të dhënave mbi gjendjen e fëmijëve dhe familjeve në Kosovë. Unë mirëpres përkushtimin e institucioneve të Kosovës për realizimin e anketave të MICS me popullatën e përgjithshme dhe komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian për t'i informuar programet që kanë për qëllim adresimin e nevojave të çdo fëmije në Kosovë, sidomos të fëmijëve dhe familjeve të cenueshme. MICS ofron një pasqyrë, që tregon se statistikant bëhen mjete për ta transformuar jetën e popullatës. Ne bëhemi më të mirë pas identifikimit të popullatës së cenueshme dhe zhvillimit të ndërhyrjeve, duke u bazuar në dëshmi të jetës reale", ka theksuar Veronika Vashchenko, udhëheqëse e UNICEF-it në Kosovë.

Dy muaj para zgjedhjeve, a është gjithçka gati?



PRISHTINË, 6 DHJETOR - Zgjedhjet parlamentare do të mbahen më 9 shkurt të vitit që vjen. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka deklaruar se kanë nisur përgatitjet për zgjedhjet parlamentare menjëherë pasi është caktuar data e mbajtjes së tyre.

Në emisionin "Ora 7" në Klan Kosova ai u shpreh se momentalisht kanë vetëm të dhëna nga lista preliminare e votuesve dhe, sipas saj, numri i qytetarëve me të drejtë vote në Republikën e Kosovës është 2 milionë 47 mijë e 148 votues. "Janë më shumë se 160 mijë votues në krahasim me zgjedhjet lokale të vitit 2021", u shpreh Elezi. Ai tregoi se për herë të parë do të kemi krijimin e qendrave komunale të

numërimit, të cilat do të vendosen në qendra sportive nga një për çdo komunë, që do të shërbejnë për numërimin e votave të kandidatëve për deputetë.

Ndryshimi tjetër në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme që ka të bëjë drejtpërdrejt me votuesin. Sipas Elezit, është edhe numri i kandidatëve që një votues ka të drejtë të votojë në ditën e zgjedhjeve. "Fillimisht është e domosdoshme që votuesi të zgjedhë në anën e majtë të fletëvotimit një subjekt politik, ndërsa në anën e djathtë mund të zgjedhë deri në 10 kandidatë për deputetë. Në zgjedhjet e kaluara ky numër ka qenë deri në pesë kandidatë. Ndryshime të tjera në ligj kanë të bëjnë

edhe me votimet jashtë Kosovës. Ka ndryshime thelbësore, ka edhe lehtësira shumë të mëdha sa i përket procesit, fillimisht regjistrimit të diasporës. Në zgjedhjet e kaluara ka pasur vetëm një mënyrë votimi dhe ajo ka qenë dërgimi i pakos me fletëvotim në adresë të kutisë postare të KQZ-së në Kosovë. E me Ligjin e ri për Zgjedhjet e Përgjithshme janë edhe dy mundësi të tjera: është votimi në përfaqësi diplomatike dhe mënyra tjetër është dërgimi i pakos me fletëvotim në adresë të kutisë postare të KQZ-së në shtete të ndryshme. Do të jenë gjithsej 22 kuti postare që planifikohet të hapen në shtete të ndryshme të botës", ka sqaruar Elezi.

Shqipëria do t'i mbajë zgjedhjet parlamentare më 11 maj

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, shpalli datën 11 maj të vitit 2025 për mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare.

Zyra e Presidencës shqiptare sqaroi për mediet se kreu i shtetit shqiptar vendosi që ta respektojë kërkesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për caktimin e datës së zgjedhjeve. "Shkaku themelor për caktimin e datës 11 maj 2025 si datë për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve qëndron në nevojën e shprehur nga KQZ-ja për ta shfrytëzuar të gjithë kohën në dispozicion për përgatitjen e infrastrukturës ligjore dhe organizative, që të bëhet i

mundur votimi i suksesshëm dhe rezultativ i shqiptarëve nga jashtë vendit", u tha në njoftimin e Presidencës shqiptare.

Gjatë konsultimeve që presidenti Begaj zhvilloi me krerët e partive politike, data 11 maj ishte propozuar edhe nga Partia Socialiste në pushtet.

Në konsultimet për datën e zgjedhjeve nuk morën pjesë përfaqësuesit e Partisë Demokratike në opozitë. Përfaqësues të kësaj partie i cilësuan farsë konsultimet e thirrura nga presidenti pasi, sipas tyre, data ishte paracaktuar nga shumica qeverisëse.

Partitë opozitare kishin shprehur shqetësim se planifikimi i samitit të gjashtë të Komitetit Politik Evropian për datat 8 dhe 9 maj të vitit 2025, dy ditë para datës së fundit të mundshëm për zhvillimin e zgjedhjeve, formon ndikim dhe avantazh të papranueshëm për qeverinë.

Për këtë çështje Presidencën sqaroi se ky aktivitet do të zhvillohet pas zgjedhjeve parlamentare, fakt ky i konfirmuar edhe nga ndërkombëtarët.

Për këto zgjedhje, presidenti Begaj kishte në dispozicion katër ditë të diela midis datave 15 prill dhe 15 maj 2025.





Kilaj, Smakaj dhe Fazliu dërgohen në Hagë

Një ditë pas arrestimit nga Gjykata Speciale, ish-kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, ish-shefi i AKI-së, Bashkim Smakaj dhe ish-luftëtari i UÇK-së, Fadil Fazliu, janë dërguar të premtën në qendrën e paraburgimit në Hagë. Ndaj arrestimit të tyre dhe procesit gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së ka pasur reagime të shumta, në mesin e tyre edhe nga PDK-ja. Kjo parti ka kërkuar nga Gjykata Speciale paanshmëri dhe transparencë në procesin gjyqësor ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit

prill të vitit 2023. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat e ZPS-së.

Procesi gjyqësor në Hagë, PDK-ja kërkon paanshmëri dhe transparencë

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka reaguar në lidhje me zhvillimet në Hagë, konkretisht për procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Kjo parti ka thënë se është duke i ndjekur me shqetësim zhvillimet e fundit që lidhen me veprimet e Dhomat të Specializuara të Kosovës. PDK-ja ka theksuar rëndësinë e ruajtjes së standardeve më të larta të drejtësisë dhe të paanshmërisë, që janë gurtheleme të funksionimit të çdo institucioni gjyqësor, përfshirë Dhomat e Specializuara. “Besojmë fuqimisht se drejtësia dhe paanshmëria nuk janë vetëm kërkesa, por kushte të domosdoshme për një proces të drejtë dhe të besueshëm. Dhomat e Specializuara u krijuan për të siguruar drejtësi, bazuar në standardet evropiane dhe jo për të krijuar spektakle publike në emër të saj. Çdo devijim nga ky mandat, përmes veprimeve që mund të minojnë besimin e qytetarëve dhe integritetin e drejtësisë, konsiderojmë se është i gabuar. Është thelbësore që të gjitha proceset e zhvilluara nga Dhomat e Specializuara të jenë të

bazuara në transparencë të plotë dhe pa tejkalluar kompetencat e tyre. Kuvendi i Kosovës ka themeluar Dhomat e Specializuara me një mandat specifik dhe të kufizuar, për të trajtuar akuzat monstruoze të raportit të Dick Martyt”, është thënë në reagimin e PDK-së. Më tutje, PDK-ja ka shprehur shqetësim për vonesat e gjata dhe mungesën e transparencës në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. “Si PDK shprehim shqetësimin tonë në lidhje me vonesat e gjata dhe mungesën e transparencës në procesin gjyqësor ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe zyrtarëve të lartë shtetërorë. PDK ka mbështetur krijimin e kësaj gjykate, me besimin dhe garancitë e dhëna nga aleatët tanë se kjo gjykatë do të funksiononte mbi parime të qarta të transparencës dhe demokracisë. Çdo qytetar i Kosovës dhe secili i akuzuar ka të drejtë të trajtohet pa paragjykim, me paanshmëri dhe drejtësi të plotë. Por, parashtrësarët e fundit nga mbrojtja e katër të akuzuarve në këtë proces, kanë ngritur shqetësime serioze për trajtimin jo të drejtë, me brenga për shkeljen e parimit të barazisë dhe prezumimit të pafajësisë. Apelojmë që Dhomat e Specializuara të përmbushin detyrën e tyre me profesionalizëm dhe paanshmëri, duke respektuar parimet themelore të drejtësisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit”, është thënë në reagimin e PDK-së.

EPOKA ERE**Lirim GECI**

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Ish-kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, ish-shefi i AKI-së, Bashkim Smakaj, dhe ish-luftëtari i UÇK-së, Fadil Fazliu, janë nisur për në Hagë nga zyrat e EULEX-it në Fushë-Kosovë.

ZPS-ja të enjten ka njoftuar se është ndërmarrë aksion i gjerë në Kosovë, ku janë kryer arrestime dhe bastisje në disa shtëpi të ish-pjesëtarëve të UÇK-së, duke përfshirë edhe shtëpinë e ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi.

Isni Kilaj ka pasur aktakuzë të ngrirë, mirëpo ajo është ndryshuar dhe ai llogaritet si i dyshuar.

Lidhur me këto zhvillime, ushtruesi i detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se Gjykata Speciale po vazhdon gjahun ndaj UÇK-së dhe luftëtarëve të lirisë. Në media u dha lajmi për arrestimin e Isni Kilajt e Bashkim Smakajt por, sipas informatave që po më vijnë, është arrestuar edhe Fadil Fazliu, vëllai i dëshmorëve Fahri e Bahri Fazliu”, ka shkruar Kinaku në



“Facebook”.

Ndërsa djali i Fadil Fazliut, Fahriu, ka kërkuar nga babi të qëndrojë i fortë. “Qëndro i fortë siç dite me qëndru i fortë e stoik edhe kur t’i vrau Serbia dy vëllezërit e tu, Heronjtë e Kombit, Fahri e Bahri Fazliu. Liri të shpejtë për gjithë çlirimtarët!”, ka shkruar Fazliu, i cili është nipi i dëshmorëve Fahri dhe Bahri Fazliut.

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka qëndruar para dyerve të EULEX-it deri në momentin e nisjes së Fadil Fazliut drejt Hagës. “Në Kosovën e lirë duke i çu në Hagë, në gjykim, duke i përshëndet pa i takuar, shtyllat e lirisë së Kosovës. Ballëlarhtë Fadil Fazliu

siç ishte përherë!”, ka shkruar Murati në “Facebook”.

Po për aksionin e fundit të Speciales ka reaguar edhe ish-eprori i UÇK-së, Zafir Berisha. Ai e ka vlerësuar Gjykatën Speciale si monstrum politik, e cila, sipas tij, po përpiket ta barazojë luftën e UÇK-së me luftën gjenocidale të Serbisë.

Berisha ka shkruar në “Facebook” se Specialja do të dështojë në misionin e saj. Kujtojmë se në Hagë është duke u zhvilluar procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ata janë arrestuar nga Gjykata Speciale në nëntor të vitit 2020, ndërsa procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar në

BE-ja: Serbia me hapa të pamjaftueshëm ndaj përgjegjësve për sulmet në veri të Kosovës

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Bashkimi Evropian do ta përsërisë thirrjen për Serbinë që "urgjentisht" t'i nxjerrë para drejtësisë përgjegjësit për dhunën në veri të Kosovës gjatë vitit 2023 dhe të bashkëpunojë plotësisht rreth këtyre rasteve. Kjo thirrje pritet të jetë pjesë e konkluzioneve për zgjerim, që flet për Serbinë, e që priten të miratohen më vonë gjatë këtij muaji në Këshillin e Çështjeve të Përgjithshme të BE-së.

"Radio Evropa e Lirë" ka pasur qasje në draftin e këtyre konkluzioneve, në të cilat i bëhet thirrje Serbisë të përmbahet nga retorika nxitëse dhe hapat e njëanshëm dhe provokues. "Këshilli përsërit dënimin e fuqishëm të akteve të dhunës nga protestuesit serbë të Kosovës ndaj qytetarëve, trupave të [misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë] KFOR-it, organeve të rendit dhe medieve më 29 maj 2023 dhe sulmet e dhunshme ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator 2023 në veri të Kosovës. Nuk ka arsytim për dhunë", thuhet në draftin e konkluzioneve që u është shpërndarë vendeve anëtare të BE-së. "Këshilli përsërit thirrjet që Serbia të bashkëpunojë plotësisht dhe të ndërmarrë hapa të domosdoshëm që të sillen urgjentisht para drejtësisë kryesit e sulmeve të vitit 2023. Këshilli nënvizon nevojën për

llogaridhënie të plotë dhe shpreh keqardhje të thellë që Serbia ka ndërmarrë hapa të pamjaftueshëm në këtë drejtim", thuhet në dokumentin që ka pasur qasje "Radio Evropa e Lirë".

Në maj të vitit 2023, në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, serbët lokalë kundërshtuan nisjen e detyrës së kryetarëve të rinj shqiptarë, të cilët dolën nga zgjedhjet e prillit të po atij viti, që u bojkotuan nga partitë dhe popullata serbe.

Protestat kulmuan më 29 maj në Zveçan, kur protestuesit u përleshën me pjesëtarët e KFOR-it dhe, si pasojë e përleshjeve, mbetën të plagosur dhjetëra persona nga të dyja palët.

Ndërkaq, më 24 shtator 2023, një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke vrarë një polic të Kosovës. Gjatë këmbimit të zjarrit që pasoi, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova fajëson për këtë sulm Serbinë, e cila mohon përfshirjen. Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë që ka mbështetur në Beogradit. Kosova ka ngritur aktakuzë ndaj tij dhe dhjetëra personave të tjerë dhe kërkon që Serbia ta ekstradojë në Kosovë.

Në konkluzione përmendet



edhe dialogu për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Aty përsëritet thirrja për Serbinë që t'i respektojë të gjitha obligimet e dialogut dhe që pa vonesa të angazhohet për zbatimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve.

Kjo marrëveshje u arrit vitin e kaluar. Palët nuk e nënshkruan atë për shkak të kundërshtimit të Serbisë, por BE-ja thotë se, pavarësisht se nuk është nënshkruar, marrëveshja është e obligueshme për palët dhe ka thënë se Kosova dhe Serbia

ende s'kanë nisur zbatimin e saj.

Në konkluzione, BE-ja ia rikujton Serbisë se obligimet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje me Kosovën janë bërë pjesë formale e procesit të negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE. Ndërkaq Presidenca hungareze e BE-së dhe Komisioni Evropian janë duke vazhduar përpjekjet për ta siguruar pajtimin e të gjitha vendeve anëtare që me Serbinë të hapet për negociatën grupkapitulli 3. Nga dhjetori i vitit 2021 Serbia nuk ka hapur asnjë kapitull në

procesin e anëtarësimit në bllokun evropian, por një numër i konsiderueshëm i shteteve anëtare as kësaj here nuk kanë dhënë pëlqim për hapjen e kapitujve me Serbinë. Si arsytim për mosdhënien e pëlqimit për hapjen e kapitujve të rinj me Serbinë diplomatët evropianë kanë përmendur mungesën e përparimit në fushën e sundimit të ligjit, në normalizimin e raporteve me Kosovën dhe refuzimin e Beogradit që t'i mbështesë sanksionet e BE-së ndaj Rusisë për shkak të luftës kundër Ukrainës.

Për herë të parë në Kosovë fillon aplikimi i metodës më të avancuar - Radioterapia Stereotaktike

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Për herë të parë në Kosovë, në Klinikën e Onkologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Shërbimin e Radioterapisë, ka filluar aplikimi i metodës më të avancuar të trajtimit - Radioterapia Stereotaktike. Kjo metodë është shumë e sofistikuar dhe përdoret për trajtimin e tumoreve dhe metastazave në tru, me dimensione prej 1 deri në 3 cm, duke rritur në mënyrë të ndjeshme efektivitetin e trajtimit.

Për ta parë nga afër fillimin e punës së kësaj procedure, Klinikën e Onkologjisë e vizitoi u. d. drejtori i QKUK-së, Osman Hajdari, i cili takoi drejtorin e Klinikës së Onkologjisë, Ilir Kurtishi, dhe stafin e klinikës, të cilët i falënderoj për punën dhe përkushtimin e tyre për ta filluar këtë procedurë të re mjekësore. Radioterapia Stereotaktike për tumoret e trurit është një formë shumë e saktë e terapisë me



rezatim që përdoret për t'i trajtuar tumoret e trurit dhe gjendje të tjera intrakraniale. Ajo ofron doza të larta dhe të përqendruara të rrezatimit në një zonë specifike, duke

minimizuar dëmtimin e indeve të shëndetshme përreth. Radioterapia Stereotaktike është veçanërisht efektive për tumoret e vogla dhe të mesme dhe mund të përdoret për

gjendje malinje dhe beninje. Karakteristikat kryesore të Radioterapisë Stereotaktike janë saktësia, teknikat e avancuara të imazherisë (MRI, CT, ose PET), përdoren për ta hartuar

vendndodhjen e saktë të tumorit.

Është metodë joinvazive, nuk kërkon ndërhyrje kirurgjikale, rrezatimi jepet nga jashtë. Aplikohet në doza të larta, në pak seanca dhe trajtimi shpesh përfundon në 1 deri në 5 seanca, në varësi të rastit. Kjo metodë ofron siguri, përqendrimi i rrezatimit minimizon ekspozimin e indeve të shëndetshme të trurit, duke ulur efektet anësore.

Deri më tani pacientët që kanë pasur nevojë për këtë lloj trajtimi janë dërguar jashtë vendit, duke shkakuar implikime të konsiderueshme buxhetore për shtetin.

Ky zhvillim i ri do t'i ulë ndjeshëm këto kosto dhe do të mundësojë trajtim cilësor brenda vendit.

Ky hap shënon një arritje të madhe për shëndetësinë në Kosovë dhe një avancim të rëndësishëm për trajtimin e tumoreve, duke ofruar shpresë dhe përkujdesje më të mirë për pacientët dhe duke kursyer burimet financiare të vendit.

Hijet e turpit të Prokurorit të Specializuar?!



Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

Historia e këtij shekulli do t'i analizojë pretendimet e kota, të sajuara, krejtësisht shpifëse të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të një gjykate të improvizuar në Hagë, e cila, në mungesë të fakteve, tani më ka rënë në dëshpërim e në ankth!

Ata, e dinë më së miri se, përse po ndodhë që, të gjitha pretendimet e tyre, kanë ngelur, në sferën e mashtrimeve, të lajthitjeve, e të përndjekjes së atyre shqiptarëve të pafajshëm të cilët, po i gjykojnë, por edhe të qytetarëve të lirë të Kosovës. Çfarëdo njohës i së drejtës ndërkombëtare, po e ka të qartë se, kjo gjykatë është dështim i plotë i drejtësisë, është shndërruar në instrument për

përndjekjen e shqiptarëve gjithnjë, sipas skenarit serb dhe aleatëve të saj, të cilët nuk janë të pakët edhe brenda shteteve të BE-së. Kjo gjykatë ndërkombëtare, është pafuqi e vetë BE-së, që të vërtetën ta mbrojë përmes të vërtetës, dhe të mos bie edhe vetë pre e shpifjeve, e projekteve dhe skenarëve të cilat e diskreditojnë demokracinë evropiane. Në një gjendje të këtyrë, siç ndodh në procesin gjyqësor në Hagë, kur Prokuroria instrumentalizohet në shërbim të kërkesave të fashizmit serb dhe aleatëve të saj, fytyra e kësaj gjykate ka marrë hijen e turpit dhe të mjerimit.

Kujt i duhen arrestimet, bastisjet e mëngjesit, pa paralajmërim, të personave të pafajshëm shqiptarë, të cilat ndodhën sot?

Arrestimet e personaliteteve të cilët, nga çlirimi e këndeje ish-in dhe janë drejtues të demokracisë, jo vetëm politike në Kosovë, kontribuues aktiv në shtetndërtimin e Kosovës së lirë, për më tepër, personalitete të respektuara në shoqërinë dhe në shtetin

tonë. Çfarë mendon, Zyra e Prokurorit të Specializuar se jemi ne shqiptarët e Kosovës, në atdheun, në shtetin, në vatrat e të parëve tanë? Ne çdo ditë e më tepër po e kuptojmë se, themelimi i Gjykatës së Hagës ishte bërë me kërkesën ultimative të Serbisë dhe aleatit të saj, kryesor, Ruisë. Ne e dimë se, themelimi i Gjykatës së Hagës ishte hakmarrje serbo-ruse ndaj popullit liridashës dhe UÇK-së guximtare, e cila, i priu luftës së popullit për çlirim nga sundimi i gjatë i Serbisë. Ne, po ashtu, e kemi të qartë se, Serbia e dëshpëruar nga disfata në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, insistoi përmes aleatëve të saj në BE, jo vetëm në Parlamentin Evropian, të formohet Gjykata Speciale, sepse, Serbia u turpërua me të gjitha ato humbje.

UÇK-ja, luftoi edhe për lirinë e serbëve kosovarë

Prandaj, tani, kur Serbia po e kupton se, do ta humb betejën edhe në Gjykatën e

Hagës, atëherë, aleatët e saj, pra, edhe në Zyrën e Prokurorit Special, të tmerruar nga kjo disfatë historike, po bëjnë shantazhe, presione, në vetë procesin e Gjykatës së Hagës, tek dëshmitarët, tek mbrojtësit kurse në të njëjtën kohë, po përsërisin arrestime dhe bastisje të shpifura. Metodrat e presionit që po i bën, Zyra e Prokurorit Special, janë krejtësisht jo demokratike, janë të dhunshme, dhe, mjerisht ju përngajnë metodave të cilat, dikur i përdorte shteti serb kundër ne shqiptarëve. Këtë po e bëjnë për t'i thënë Serbisë se, ja, ne bëmë gjithçka, nuk lamë gur pa lëvizur, por, nuk po kemi fakte, argumente, para së gjithash, dëshmi për t'i akuzuar, fajësuar, dënua çlirimtarët të cilët po i mbajmë në burg!

Në rastin e procesit të montuar të Gjykatës së Hagës, kundër çlirimtarëve tanë, duhet të fitojë drejtësia e cila, edhe në këto rrethana dhe çaste që po mbahet peng e skenarëve serbe, ruse dhe të aleatëve të tyre, bëjmë thirrje qytetërimin evro-

perëndimor, mos të bëhet mashë e politikave ndëshkuese dhe hakmarrëse serbe. Populli ynë, nën drejtimin e UÇK-së dhe të çlirimtarëve, të cilët po mbahen në burg, ka luftuar për vlerat më të larta të qytetërimin të sotëm, luftës për tu çliruar nga prangat e sundimit serb! A ka luftë dhe vlerë më fisnike për një popull siç është populli ynë, sesa të luftosh për vlerat më sublime: çlirimi nga sundimi, liria si histori, demokraci universale!? UÇK-ja luftoi dhe ngadhënjë për lirinë si kuptim universal, për të gjithë qytetarët, banorët e Kosovës, pra, edhe për çlirimin e serbëve kosovarë dhe pakicave të tjera, nga sundimi i regjimit pushtues, totalitar të Serbisë! Liria e qytetarëve të Kosovës, është vlerë e qytetërimin dhe e barabartë dhe si e tillë, ajo, liria nuk ndahet mbi bazat etnike! Çlirimtarët tanë, të cilët ende po mbahen në burg, janë pikërisht ata prijës të cilët, gjatë luftës dhe në kohë paqeje, e promovuan këtë filozofi të lirisë për të gjithë!

Kush e lyp kokën e Hashim Thaçit?

Shkruan: **Sali BISLIMI**

Shkrimtari Riza Greiçevci vjen me librin e sapobotuar, i cili me shumë përkushtim e promovoi në odën tonë. Me bacin Riza na lidh origjina e familjeve tona, atje lart në malësi, ku të parët tanë kanë kuvendu në një hije lisi Topillë - Greiçevcë.

Dhimbja e historisë së Kosovës është më e thellë sa një oqean, një natë e tërë duke dëgjuar për të gjitha vuajtjet e këtij populli, me emocion të thellë na tregon një historik të detajuar të mësuësit Fazli Greiçevci që e kishte djalë të axhës, sa rrëqethëse dhe e dhimbshme.

Ky libër i botuar së fundi në mbrojtje të presidentit Hashim Thaçi është një dëshmi e fuqishme dhe vendimtare në peizazhin aktual politik të Kosovës. Përmes analizave të thella dhe të nuancuara, autori nënvizon kontributet e rëndësishme të Thaçit në luftën për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, duke trajtuar polemikat e shumta që e rrethojnë.

Duke përshkruar jo vetëm sukseset e tij, por edhe sfidat kryesore me të cilat u

përball, shkrimtari u ofron lexuesve një këndvështrim pasurues që shkon përtej rrëfimeve të thjeshtuara.

Ky libër synon të inkurajojë dialogun konstruktiv për trashëgiminë politike të presidentit Thaçi, duke i ftuar të gjithë të reflektojnë mbi sfidat me të cilat Kosova vazhdon të përballet në kërkimin e saj për njohje drejtësi dhe stabilitet ndërkombëtar.

Duke rivendosi një zë shpesh të lënë pas dore, kjo vepër është një kontribut thelbësor në debatin publik, duke pohuar nevojën për një kuptim më të thellë të çështjeve që formojnë strukturën politike dhe shoqërore të Kosovës bashkëkohore.

Autori tregon kështu se e kaluara nuk duhet të shtypet, por të kuptohet dhe analizohet për të ndërtuar një të ardhme më të mirë.

Disa foto që do të mbetën kujtim i paharruar për bisedat tona të gjata deri në mëngjes duke treguar dashurinë dhe përpjekjet e popullit tonë për Kosovën e lirë.

Është një thënie që thotë: "Qeni nuk e han dorën e cila e ushqen" por këta qenë që duan ta hanë lirinë dhe shtetin e Kosovës ushqehen nga vendet anti-Kosovë!



Si mund të luftohet futja e armatimit në veri?

Edhe këtë javë po qëndrojmë pashmangshëm në veri të Kosovës, ku sulmi i 29 nëntorit me mjete shpërthyes në kanal in e Ibër-Lepencit mori gjithë vëmendjen, dhe aktualizoi edhe një herë pyetjen që bëhet shpesh: Prej nga po futet armatimi në Kosovë?

PRISHTINË, 6 DHJETOR - "Është sekret publik që veriu i Kosovës ka pasur shumë armatim. Ka qenë depo e armatimit". Kështu e ka përshkruar drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, këtë pjesë të territorit, teksa ka folur në Radiotelevizionin e Kosovës për armatimin që gjendet vazhdimisht gjatë bastisjeve policore.

Në më pak se një javë, policia ka gjetur dy herë armatim dhe uniforma ushtarake në veri të Kosovës, në aksionet e kryera pas sulmit të 29 nëntorit në kanal in e Ibër-Lepencit, në Zubin Potok. Policia ka thënë se sulmi ndaj kanalit - nga ku furnizohen me ujë nga Liqeni i Ujmanit disa qytete të vendit, si dhe Korporata Energjetike e Kosovës për ftohjen e termoelektraneve të saj - është kryer me një sasi eksplozivi prej rreth 20-kilogramësh.

Ndërkaq, ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë se lënda e përdorur në sulmin në kanal "është e pamundur të gjendet, nëse nuk furnizohet drejtpërdrejt nga depot e ushtrisë". Autoritetet e Kosovës fajësojnë Serbinë për futje të armatimit në Kosovë, si dhe për organizimin dhe kryerjen e sulmeve që i konsiderojnë terroriste, në kanal in e Ibër-Lepencit dhe në Banjskë të Zveçanit, një vit më parë.

Beogradi mohon gjithçka, madje për sulmin e fundit ka ofruar edhe ndihmë për kryerje të hetimeve.

Sfida në kufirin Kosovë - Serbi

Dogana e Kosovës i ka thënë më parë Radios Evropa e Lirë se armatimi ka hyrë përmes



"rrugëve malore". Sipas zyrtarëve të saj, para sulmit në Banjskë, disa lloje armësh kanë mundur të hyjnë në Kosovë edhe brenda ditës përmes rrugëve ilegale. Ndërkaq, shefi i Policisë ka thënë se dhjetëra rrugë ilegale me Serbinë tashmë janë bllokuar, por sfida përbën pamundësinë e zyrtarëve policorë për të qenë shumë afër kufirit.

Dy vendet ndajnë një vijë kufitare të gjatë rreth 400 kilometra. Mbi 60 për qind e saj përfshin komuna të banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës. Një pjesë e konsiderueshme është zonë me terren të vështirë, të pabanueshëm. Edhe ky fakt e bën gati të pamundshëm kontrollimin e çdo pjesë kufitare. Për sigurinë e kufijve të Kosovës me Serbinë është përgjegjës misioni i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, KFOR, ndërsa për pjesën tjetër të vijës kufitare kujdeset

Policia e Kosovës.

Megjithatë, sipas një vendimi të vitit 2014 të komandantit të KFOR-it atëbotë, Policia mund të patrullojë në vijën kufitare Kosovë-Serbi deri në 1 kilometër afër vijës ndarëse.

Ish-drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, beson se rrugët ilegale po kontrollohen pak, ose fare pak, dhe ndonëse lëvdon punën që po bëjnë zyrtarët policorë, ai thotë se atyre po u mungon elementi kryesor: informacioni. "Institucionet e sigurisë, sidomos Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), të jenë shumë më vigjilente, e po ashtu inteligjenca që është në kuadër të Policisë së Kosovës të jetë më shumë në terren, dhe të veprohet në mënyrë proaktive".

Kufijtë e tjerë

Qalaj thotë për REL-in se ka informacione që, përveç prej

mundësisë së hyrjes së armëve dhe pajisjeve ushtarake në territorin e Kosovës".

Armët e konfiskuara

Policia ka thënë disa herë se armët e konfiskuara janë të vjetra dhe variojnë, prej municioneve e granatahedhësve, e deri tek armët e kalibrit të lartë, mitralozët, snajperët, minat kundër këmbësorisë, e detonatorët.

Njësia e Forenzikës Digjitale e Radios Evropa e Lirë ka verifikuar se disa armë janë prodhuar në periudhën 1990/91 në fabrikat serbe "Prvi Partizan" dhe "Millan Bllagojeviq". Policia e Kosovës nuk ka ofruar informacione me gjithë kërkesën e REL-it për të kuptuar se sa persona janë arrestuar ndër vite për futje të armëve në Kosovë.

Rreziku ndaj sigurisë

Në raporte vendore e ndërkombëtare, situata e sigurisë në veri konsiderohet e qetë, por e brishtë, me potencial të përshkallëzimit të shpejtë. Drejtori i Policisë, Hoxha, e ka përsëritur disa herë që institucioni që udhëheq ka, në parim, potencial për të kryer bastisje masive në veri, por nuk mund të veprojë ashtu, pasi gjithçka duhet të kryhet në përputhje me ligjin dhe duhet të ekzistojë dyshim i bazuar.

Njohësit e sigurisë në Kosovë kanë sugjeruar shpesh përdorimin e dronëve për mbikëqyrjen e kufijve, vendosjen e kamerave në zona më kritike kufitare, apo rritjen e presionit ndërkombëtar ndaj Serbisë.

Bedri Hamza, rrëfim emocional: Sakrificat e babait dhe solidariteti i nënës, vlera që më udhëheqin në jetë

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Kandidati për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës, Bedri Hamza, ka ndarë një rrëfim të thellë dhe emocional përmes një videoje të publikuar në rrjetet sociale. Ky rrëfim pasqyron sfidat që ai dhe familja e tij kanë përjetuar ndër vite, duke u fokusuar në sakrificat e hershme dhe në mësimet jetësore që kanë formësuar karakterin e tij.

Në këtë rrëfim Hamza ka kujtuar rolin e babait të tij, i cili punonte në "Trepçë", por u detyrua të dalë në pension të parakohshëm për shkak të problemeve shëndetësore. "Baba ka qenë punëtor në 'Trepçë', por shëndeti nuk e ka lejuar të punojë gjatë. Për këtë arsye u

pensionua shumë i ri, gjë që më detyroi mua të nis punën që në moshë të re", ka rrëfyer Hamza, duke shtuar se e filloi karrierën po në "Trepçë", duke ndjekur shembullin e babait.

Ai flet me konsideratë të lartë edhe për nënën, një grua e cila jo vetëm që u përkushtua për rritjen e fëmijëve, por adoptoi katër fëmijë të mbetur pa prindër, duke u kthyer në një shembull frymëzues të humanizmit dhe solidaritetit.

Në këtë mesazh të fuqishëm, Bedri Hamza u zotua se si kryeministër do të angazhohet për krijimin e mundësive të barabarta për çdo familje në Kosovë, duke synuar një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e vendit.



Raporti i ASK-së: Qeveria rriti shpenzimet këtë vit

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare për tremujorin e tretë (TM3 2024). Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe. Gjithsej të hyrat e qeverisë së përgjithshme në TM3 2024 ishin 818.7 milionë euro, ndërsa të hyrat në TM3 2023

ishin 723.9 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë: Tatimet në produkte (78 %), tatimet rrjedhëse në të ardhura (13 %), ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori tjera të të hyrave. Gjithsej shpenzimet e qeverisë së përgjithshme në TM3 2024 ishin 774.8 milionë euro, ndërsa shpenzimet në

TM3 2023 ishin 705.5 milionë euro. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë kompensimi i punëtorëve 26%, kontributet sociale dhe përfitimet 22 %, konsumi i ndërmjetëm 16 %, formimi i kapitalit bruto 13 %, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategori të tjera të shpenzimeve.



Kuvendi i Kosovës miratoi tri ligje kyçe për zhvillimin financiar të vendit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar në seancën e fundit tri ligje kyçe për zhvillimin financiar të vendit, duke i hapur rrugë anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Zonën e Vetme të Pagesave Evropiane (SEPA). Ligjet e miratuara përfshijnë Ligjin për Bankat, Ligjin për Shërbimet e Pagesave dhe Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Terrorizmit dhe përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt integritimit në tregun e vetëm të BE-së dhe përmirësimit të transparencës financiare në vend.

Me këto ligje në fuqi, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) tashmë mund t'i miratojë rregulloret e nevojshme për zbatimin e tyre, që do ta mundësojë finalizimin e aplikimit zyrtar për anëtarësim në SEPA. Kosova ka bërë tashmë para-aplikimin për anëtarësim



në SEPA më 14 tetor 2024, duke dorëzuar dokumentacionin përkatës në DG FISMA dhe Këshillin Evropian të Pagesave (EPC). Aktualisht vendi është në pritje të

komenteve dhe rekomandimeve nga këto institucione, duke hapur kështu rrugën për dorëzimin e aplikimit final. Anëtarësimi i Kosovës në SEPA do të sjellë përfitime të

prekshme dhe konkrete për qytetarët e vendit. Pagesat ndërkufitare do të bëhen më të lira, duke kursyer deri në 55 milionë euro në vit nga remitanatcat dhe tregtia

ndërkombëtare, një lehtësim i madh për familjet që pranojnë para nga të afërmit jashtë vendit dhe për bizneset që operojnë me partnerë ndërkombëtarë. Përpunimi i transaksioneve do të jetë shumë më i shpejtë, shpesh brenda sekondave, duke rritur efikasitetin dhe duke ulur vonesat në kryerjen e pagesave. Siguria financiare do të rritet, duke garantuar mbrojtje më të madhe ndaj mashtrimeve dhe aktiviteteve të paligjshme. Gjithashtu, transparenca në transaksione do të përmirësohet ndjeshëm, duke ndihmuar në uljen e ekonomisë joformale dhe në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave. Përfundimisht, anëtarësimi në SEPA do ta lidhë Kosovën më ngushtë me ekonominë evropiane, duke e integruar atë më mirë në tregun financiar ndërkombëtar dhe duke forcuar lidhjet ekonomike me vendet e BE-së, që kontribuon në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Rizvanolli: Në të kaluarën 'Trepça' nuk është audituar nga ZKA-ja për 10 vjet, KEK-u e 'Ibër Lepenci' për më shumë se 5 vjet



PRISHTINË, 6 DHJETOR - Ministri e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka deklaruar se në të kaluarën disa ndërmarrje të vogla si "Drini i Bardhë" janë audituar çdo vit, ndërsa "Trepça" nuk është audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për 10 vjet, kurse KEK-u e "Ibër Lepenci" për më shumë se 5 vjet.

Në një intervistë për KTV, ministri Rizvanolli ka deklaruar

se keqpërdorimi, mungesa e kontrollit, mungesa e transparencës që ka qenë në "Trepçë", e tejkalon përvojën e çdo ndërmarrje tjetër publike dhe, siç ka vlerësuar ajo, nuk ka qenë e rastësishme që nuk e ka audituar Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA). Ajo, po ashtu, është shprehur se ndër gjërat më të mira që i kanë bërë si ministri, është kërkesa

për auditim, por këtu ka meritë edhe Zyra Kombëtare e Auditimit që, përveç profesionalizmit gjatë punës që e bëjnë në ndërmarrje publike dhe kur i përzgjedhin ndërmarrjet për auditim, sigurohen që të auditohen ndërmarrjet e mëdha dhe, gjithashtu, sigurohen që plani të jetë i tillë që të ketë mbulueshmëri të ndërmarrjeve që kanë risk më të lartë.

Policia konfiskon mbi 22 mijë euro para të padeklaruar

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Policia e Kosovës, respektivisht Policia Kufitare, në vazhden e kryerjes së detyrave përkatëse sipas autorizimeve policore, të premtën rreth orës 02:20 në pikëkalimin kufitar në Bërnjak,


gjatë një kontrolli të hollësishëm kufitar, në kabinën e një kamioni me targa RKS, me vozitës mashkull kosovar, ka hasur në një qese me 22 700 (njëzet e dy mijë e shtatëqind) euro, mjete monetare

financiare të padeklaruar (në bankënota prej 100 dhe 200 eurosh). Lidhur me rastin mjetet financiare të padeklaruar janë sekuestruar dhe i janë dorëzuar Doganës së Kosovës për

procedurë të mëtejme, ndërsa Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit dhe dukurive të tjera negative dhe vënien para përgjegjësisë së personave, kryes të veprave penale.



'I dashur Scott, harroje tragjedinë tënde'. Letra e Hemingwayt për F. Scott Fitzgeraldin



Në 19 maj të vitit 1934, një muaj pas botimit të romanit të tij, "E butë është nata", F. Scott Fitzgeraldi i shkruajti mikut të tij, Ernest Hemingway, dhe e pyeti për mendimin e tij të sinqertë për librin – një rrëfim për Dick dhe Nicole Diver, një çift, personazhet e të cilëve bazoheshin në njerëz të njohur të të dyve, Fitzgeraldit dhe Hemingwayt: Gerald dhe Sara Murphy.

Sigurisht që Hemingway iu përgjigj sinqerisht. Kjo është përgjigja e tij – një letër që përmban shumë këshilla – për shkrimtarin.

Key West
28 maj 1934

I dashur Scott:

Më pëlqeu dhe nuk më pëlqeu. Fillon me atë përshkrimin e mrekullueshëm të Saras dhe Geraldit (ta hajë dreqi, Dos e mori me vete, kështu që nuk i referohem dot. Kështu që, nëse bëj ndonjë gabim...). Më pas ti filloje të bëje shaka me ta, duke i bërë të vijnë nga gjëra prej të cilave ata nuk vijnë, duke i ndryshuar në njerëz të tjerë, dhe këtë nuk mund ta bësh, Scott. Nëse merr njerëz realë dhe shkruan për ta, nuk mund t'u japësh prindër të tjerë nga ata që kanë (ata formohen nga prindërit e tyre dhe ajo që u ndodh atyre), nuk mund t'i bësh që të bëjnë gjëra që ata vetë nuk do t'i bënin. Ti mund të marrësh ty, ose mua, ose Zeldën, ose Paulinën, ose

Hadleyn, ose Saran, ose Geraldin, por duhet që të gjithë t'i ruash ashtu si janë. Nuk mund të marrësh një njeri dhe ta shndërrosh në një tjetër. Krijimi është gjëja më e mirë, por nuk mund të krijosh diçka që në fakt nuk mund të ndodhë.

Këtë duhet të bëjmë ne kur jemi në të mirën tonë – të krijojmë gjithçka – por ta krijojmë në mënyrë kaq të vërtetë, sa që më vonë, të ndodhë pikërisht ashtu.

Ta hajë dreqi, i ke lejuar vetes të marrësh të kaluarat dhe të ardhmet e njerëzve, të cilat prodhuan jo njerëz, por raste historikë të rremë. Ti, që mund të shkruash më mirë se kushdo tjetër, që ke kaq shumë talent sa që... ta hajë dreqi. Scott, për hir të Zotit, shkruaj, dhe bëje vërtetësisht, pavarësisht se kë apo çfarë lëndon, por mos bëj kësi kompromise idiote. Ti mund të shkruaje një libër të këndshëm për Geraldin dhe Saran, për shembull, po të dije mjaftueshëm në lidhje me ta dhe ata nuk do të kishin asnjë lloj ndjenje, përveçse do e linin të kalonte, po të ishte e vërtetë. Ka vende të mrekullueshëm, dhe askush tjetër nuk mund të shkruaj as sa gjysma jote, por ta hajë dreqi, ke bërë shumë hile në këtë libër. Dhe nuk ke nevojë.

Së pari, gjithmonë kam menduar gjithmonë se ti nuk mund të mendosh. Dakord, po pranojmë që mund të mendosh. Por le të themi që nuk do të mund të mendoje;

atëherë duhet të shkruash, krijosh, nga ato që ti di, dhe duhet që t'i përshkruash drejt, ngjarjet e të kaluarës së njerëzve. Së dyti, prej shumë kohësh, ti ke pushuar së dëgjuari, përveç se përgjigjet e pyetjeve që bën po vetë. Kishte gjëra të mira libri, që në fakt nuk i nevojiteshin. Pikërisht kjo gjë e than një shkrimtar (të gjithë thahemi, kjo nuk është fyerje personale për ty), pra të mos dëgjuarit. Prej këtu burojnë të gjitha. Të shohësh, të dëgjosh. Ti sheh shumë mirë. Por ti pushon së dëgjuari.

Eshtë shumë më mirë nga sa them unë. Por nuk është aq mirë sa mund të bësh ti.

Ti mund të studiosh Klausevicin në fushëbetejë dhe ekonominë e psikologjinë, dhe asgjë tjetër nuk të bën mirë, kur ulesh të shkruash. Ne jemi si akrobatë të lodhur, por ne bëjmë disa kërcime të mirë, ndërkohë që ka shumë akrobatë të tjerë që nuk kërcejnë.

Për hir të Zotit, shkruaj, dhe mos e vri mendjen se çfarë do të thonë djemtë, apo nëse do të jetë kryevepër, apo jo. Unë shkruaj një faqe kryevepër, për 90 faqe muti. Përpiqem që mutin ta hedh në kosh. Ti ndihen sikur të duhet të publikosh plehra, për të fituar para, për të jetuar dhe lësh të jetojnë. Të gjithë shkruajnë, por nëse ti shkruan mjaftueshëm dhe aq mirë sa mundesh, atëherë do të ketë të njëjtën sasi kryeveprash (siç themi ne në Yale). Ti nuk mendon aq mirë sa

duhet, për t'u ulur dhe shkruajtur një kryevepër, dhe nëse ti mund të heqësh qafe Seldesin dhe ata të tjerët që pothuajse të shkatërruan, dhe nëse lë spektatorët të thërrasin kur është mirë dhe të fërshëlajnë kur është keq, atëherë do të jesh në rregull.

Harroje tragjedinë tënde personale. Të gjithë jemi të katranosur që në fillim, dhe sidomos ty duhet të të dhembë shumë përpara se të ulesh dhe shkruash seriozisht. Por kur ke atë drej dhimbjeje, përdore – mos bëj hile me të. Qëndroji po aq besnik asaj, dhimbjes, sa një shkencëtar – por mos mendo se një gjë ka ndonjë farë rëndësie sepse të ndodh ty, apo dikujt që të përket ty.

Tashmë nuk do të të vija faje nëse do të shpërtheje kundër meje. O Zot, është e mrekullueshme t'u thuash të tjerëve si të shkruajnë, jetojnë, vdesin etj.

Dua të të takoj dhe të flas esëll me ty për gjërat. Ti kutërboje në Nju Jork dhe nuk shkuam askund. Shiko, Bo, ti nuk je personazh tragjik. As unë. Ne jemi shkrimtarë, dhe ajo që duhet të bëjmë, është që të shkruajmë. Nga të gjithë njerëzit mbi tokë ti kishe nevojë për disiplinë në punën tënde, dhe ti u martoveme dikë që është xhelozë për punën tënde, dëshiron të konkurrojë me ty dhe të shkatërron ty. Nuk është kaq e thjeshtë dhe unë mendova se Zelda ishte e çmendur herën e parë që e takova, dhe ti i ndërlikove gjërat

pasi ishe në dashuri me të, dhe sigurisht, ti je i çuditshëm. Por ti nuk je më i çuditshëm se sa Joyce dhe shumica e shkrimtarëve të mirë, kështu janë. Por Scott, shkrimtarët e mirë rikthehen gjithmonë. Gjithmonë.

Ti je dy herë më i mirë tani, se sa ishe në atë kohën kur ti mendon se ke qenë i mrekullueshëm. E di, nuk kam menduar aq shumë për Gatsbyn në atë kohë. Ti mund të shkruash dy herë më mirë tani. Gjithë sa duhet të bësh është që të shkruash me vërtetësi dhe të mos e vrasësh mendjen për fatin e librit.


Shko dhe shkruaj.

Sido që të jetë, jam shumë krenar për ty dhe do të doja të flisnim ndonjëherë. Ia kemi kaluar mirë duke folur ne të dy. E mban mend atë tipin që shkuam ta takojmë, kur po vdiste në Neuilly? Ishte këtu këtë dimër. Djalë i mirë Canby Chambers. Eshtë në formë tani dhe vjet në këtë kohë ishte shumë i sëmurë. Si janë Scotty dhe Zelda? Pauline të dërgon të fala. Ne jemi të gjithë mirë. Ajo do të shkojë në Piggot për disa javë me Patrickun. Më pas do të sjellin Mumbyn. Kemi një varkë të lezetshme. Unë po eci mirë me një histori shumë të gjatë. E vështirë për t'u shkruajtur.

Gjithmonë miky yt,
Ernest

Perkthimi: Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Emërllahu, lojtari i parë që kap vlerën një milion euro

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Faqja e specializuar e transferimeve dhe statistikave Transfermarkt ka publikuar të premtën përditësimin e fundit të vlerave të futbollistëve, ku pjesë e saj ishte edhe Superliga e Kosovës. Nga sot futbollisti më i vlefshëm në Superligën e Kosovës është mesfushori i Ballkanit dhe i Përfaqësueses së Kosovës, Lindon Emërllahu. Sipas

Transfermarkt, 21-vjeçari therandas tani në treg ka vlerë një milion eurosh, e cila është rritur për 400 mijë euro pasi më parë vlerë 600 mijë. Në vendin e dytë renditet braziliani i Ballkanit, Giovanni, me vlerë 900 mijë euro, teksa top treshen e kompletton ylli i Malishevës, Drilon Hazrollaj, me vlerë 800 mijë euro apo një rritje prej 50 mijë eurosh nga vlerësimi i

fundit. Najeeb Yakubu (Prishtina), Egzon Bejtullai (Drita), Drilon Islami (Prishtina), Albert Dabiqaj (Drita), Albin Krasniqi (Prishtina) dhe Etnik Brruti (Malisheva) janë lojtarët e radhës me një vlerë prej 500 mijë eurosh në treg. Top 10-shën e përmbyll Ron Broja i Dritës me një vlerë prej 450 mijë eurosh, po aq sa vlen edhe Sunday Atetunji i Ballkanit

në pozitën e 11-të. Kushtrim Shabani, Beknaz Almazbekov, Arlind Veliu, Almir Ajzeraj, Walid Hamidi dhe Senad Jarovic vlejné nga 400 mijë euro në treg. Rritjen më të madhe në përqindje në këtë vlerësim e pati talenti i Dukagjinit, Hekuran Berisha, i cili ka marrë një rritje prej 2 900 % apo një vlerë prej 300 mijë eurosh në treg. Përveç tyre, rritje të ndjeshme ka pasur



edhe Superliga e Kosovës, e cila me të gjithë lojtarët tani vlerësohet 38 milionë euro.

Sot dy ndeshje në Superligë, dy të tjera nesër

“Epoka e re”

SUHAREKË, 6 DHJETOR - Fundjava do të sjellë super ndeshje në Pro Credit Superligë. Xhiroja e 11-të do të hapet me sfidën ndërmjet skuadrave verdhezi, Golden Eagle Yllit dhe Pejës apo ish-kampionëve, ku pritet një përballje mjaft interesante. Të dyja skuadrat kanë nga pesë fitore e pesë humbje, andaj pritet një sfidë e barabartë. Duelin e parë në këtë edicion e fitoi Ylli (79:80). Bora me Bashkimin do të ndeshen sërish, kësaj radhe në elitë, pasi të enjten u ndeshën për Kupë, ku prizrenasit fituan me

22 pikë dallim, 66:88. Në Pro Credit Superligë skuadra prishtinase ka një fitore e tetë humbje, duke u renditur e fundit, ndërsa ajo prizrenase ka tetë fitore e dy humbje. Duel me mjaft rëndësi zhvillohet në mes të Proton Cable Prizrenit dhe Vëllaznimit, skuadrave të renditura në vendin e shtatë, përkatësisht të gjashtë. Prizrenasit kanë dy fitore e tetë humbje, kurse kuqezinjët katër fitore e gjashtë humbje. Java e 11-të do të përmbyllet me superderbin ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Trepçës, dy skuadrave rivale dhe me traditë në basketbollin e Kosovës. Bardhekaltrit kanë

gjashtë fitore e tri humbje, ndërsa ‘Xehetarët’ tetë fitore dhe dy humbje. Në sfidën e parë të këtij edicioni prishtinasit fituan në “Minatori” 76:82.

PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 11

T° shtun°n takohen:
17:00 Golden Eagle Ylli - Peja
19:00 Bora - Bashkimi

T° diel°n takohen:
17:00 P. C. Prizren -



Ndeshje interesante në elitën e futbollit



“Epoka e re”

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Ndeshje interesante do të zhvillohen sot dhe nesër si dhe të martën që vjen në Superligën e Kosovës në futboll. Kryesuesja e elitës, Drita, që po kalon nëpër një formë të mirë, e pret Dukagjinin e Ismet Munishit. Kjo ndeshje pritet të jetë e zjarrtë për faktin se klubi nga Klina di t'i befasojë klubet që pretendojnë titullin. Ndeshja tjetër që zhvillohet sot (e shtunë) është në mes të Prishtinës dhe Gjilanit. Kryeqytetasit në katër ndeshjet e fundit nuk dinë për humbje dhe synojnë tri pikët e plota, derisa gjilanasit pas humbjes nga Malisheva në xhiron e kaluar tash synojnë rezultat

pozitiv në ndeshjen që do të zhvillohet në stadiumin “Fadil Vokrri”. Të dielën Malisheva, e cila po vazhdon fuqishëm garat në Superligë, e pret Feronikelin '74 nga e cila ndeshje pret fitore. Ndërsa kampioni në fuqi, Ballkani, pas eliminimit nga Kupa, synon këndelljen në përballje me Ferizajn. Të martën që vjen zhvillohet ndeshja në mes të Suharekës dhe Llapit.

SUPERLIGA - Java 16

T° shtun°n takohen:
Drita - Dukagjini
Prishtina - Gjilani

T° diel°n takohen:
Malisheva - Feronikeli
Ferizaj - Ballkani

T° mart°n takohen:
Suhareka - Llapi

Vashat e Kosovës U17 dhe U19 mësojnë kundërshtarët për kualifikimet e Evropianit

NION, 6 DHJETOR - Në selinë e UEFA-s në Nion të premtën është bërë tërheqja e shortit për kualifikimet e Kampionatit Evropian për kombëtaret e grupmoshave U17 dhe U19 në konkurrencën e vazhduar. E pranishme në short nga FFK-ja ishte Sanije Krasniqi.

Përfaqësuesja e Kosovës U17 në kualifikimet për Evropianin që do të mbahet në Ishujt Faroe do të garojë në Ligën A në Grupin A7, ku bëjnë pjesë edhe Gjermania, Austria dhe Danimarka. Ndeshjet e këtij grupi zhvillohen në Gjermani, prej 15 deri më 24 mars të vitit

të ardhshëm. Dy pozitat e para kualifikohen, derisa pozita e fundit bie në Ligën B. Ndërkaq, Kosova U19, e cila do të garojë në Ligën B, pas eliminimit nga faza e parë e kualifikimeve në Ligën A, është përfshirë në Grupin B3, ku janë edhe Letonia, Kazakistani dhe Malta.

Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen në Maltë, prej 1 deri më 7 prill të vitit të ardhshëm. Gjashtë ekipet e para të çdo grupi dhe ekipi i dytë më i mirë nga Liga B do të promovohen në Ligën A për raundin e parë të kualifikueseve të edicionit të ardhshëm.




Messi: Guardiola dhe Ronaldinho kanë ndikuar në karrierën time

BARCELONË, 6 DHJETOR - Leo Messi, në një intervistë të gjatë për "Mundo Deportivo", është rikthyer pas në kohë duke kujtuar periudhën e tij të artë me Barcelonën, trofetë e shumë të fituar dhe njerëzit të cilët kanë spikatur në karrierën e tij brilante: "Ajo që kujtoj me

kënaqësi është rrugëtimi që kanë kryer, periudhën me Guardiolan në bankinë, 'tripletën' me Luis Enriquen, për të vijuar më pas Ligën e Kampionëve në vitin 2006 të fituar me Ronaldinhon, atë vit fituam gjashtë trofe. Unë uroj shumë që Barcelona të

rikthehet sërish në këto nivele, të fitojë sërish La Ligën", u shpreh Messi. Ylli botëror u ndal më pas te dy personazhe në veçanti për të cilët thotë se kanë pasur ndikim në karrierën e tij. "Guardiola dhe Ronaldinho janë dy personat që kanë

ndikuar jashtëzakonisht shumë në karrierën time. Me Pepin kemi bërë gjëra të jashtëzakonshme, ndërsa Ronaldinho më ka ndihmuar shumë në hapat e mi të parë në skuadër. Sigurisht kujtoj me kënaqësi edhe shokë të tjerë si Iniesta apo Xavi, apo lojtarë që



tani luajnë me mua në Amerikë, Sergio Busquets, Jordi Alba dhe Luis Enrique", u shpreh Messi.

Hapet ekspozita 'Lobimi përmes sportit', shfaq sfidat drejt anëtarësimit të Kosovës në UEFA dhe FIFA

PRISHTINË, 6 DHJETOR - 50 fotografi që dëshmojnë rrugëtimin e Kosovës drejt anëtarësimit në UEFA dhe FIFA janë shfaqur sot në ekspozitën "Historiku dhe promovimi për pranimin e Kosovës në sportin ndërkombëtar nëpërmjet aparatit fotografik" e autorit Blerim Uka.

Fotografi që përfshijnë periudhën nga viti 2005 deri më sot shpërfaqin sfidat nëpër të cilat ka kaluar futbollit i Kosovës deri në ditët e sotme, me theks të veçantë në vitet pas luftës. Autori Blerim Uka tha se në vitet e para të pas luftës, edhe pse në kushte shumë të vështira, arriti që përmes fotografive të llobojë për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare sportive. "Unë asnjëherë nuk kam pritur kur kam nisur në vitin 2003 me Llapin apo në Drenicë duke fotografuar në kushte të vështira, po duke e dashur futbollin në izolimin të cilin kemi qenë pas luftës jemi munduar, veçmas pas pavarësisë me mënyrën time fotografike, me një top, me një ndërresë të lloj për pranimin e Kosovës", tha Uka.

Ai tregoi edhe për njërin nga fotografitë e tij që bëri bujë të madhe në mediet botërore.



"Është ky kroati këtu me 'Accept Kosova in UEFA'. Unë kam qenë me shallin e Kosovës dhe në momentin kur më është ofruar ma ka marrë shallin. Unë i kisha 20 topa, e kam pasur një pompë të vogël dhe në atë moment e kam fryrë topin dhe është fotografuar nga fotografi i agjencisë më të madhe botërore AFP. Atëherë nuk kemi pasur internet në telefona, por kur kam shkuar në stadium, e kam parë NCC, BBC dhe shumë medie të botës që kroatët e kërkojnë pranimin e Kosovës", kujton Uka.

Hapjen e kësaj ekspozite e vlerësoi lart edhe ish-sekretari i

Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu. "Thuhet që fotografia flet vetë. Është e vërtetë. Këto nuk mund të zhdruken, nuk mund të humben dhe pjesa kryesore ka qenë pranimi i Federatës së Futbollit të Kosovës në UEFA, pastaj edhe në FIFA dhe më vjen mirë që të gjitha ju mediet e keni marrë një rrugëtim së bashku me federatat, me shtetin. Keni qenë pjesë aktive e këtij procesi", ka deklaruar Salihu.

Të pranishëm në hapjen e ekspozitës kishte figura të rëndësishme nga sporti vendor, por edhe nga politika dhe Ministria e Sportit.

Clevelandi, 'leksion' Denverit, Golden State rikthehet te fitorja

OHIO, 6 DHJETOR - Pas pesë humbesh radhazi, ekipi i Golden States rikthehet te fitorja në kampionat, duke mundur me rezultat 99-93 Houstonin.



Mungesa e Curryt nuk ndikoi shumë, teksa u dallua Cuminga me 33 pikë e Wiggins me 23 pikë. Clevelandi mbetet ekipi më i mirë në NBA, duke mundur

me rezultat 126-114 Denverin pretendent. Mitchell me 28 pikë ishte lider për Cavaliersin, mbështetur edhe nga Garland me 24 pikë. Për Denverin, Jokiçi realizoi një "triple-double" (27 pikë, 20 rebounde, 11 asistime). Fitoi edhe Oklahoma, 129-92 ndaj Torontos, duke kryesuar në perëndim. Vendimtar për miqtë Alexander Shai, autor i 30 pikëve.

Memphisi, falë 60 pikëve të ardhura nga lojtarët e stollit, mundi me rezultat 115-110 Sacramenton.

REZULTATET

Cleveland - Denver	126-114
Washington - Dallas	101-137
New York - Charlotte	125-101
Toronto - Oklahoma	92-129
Memphis - Sacramento	115-110
New Orleans - Phoenix	126-124
San Antonio - Chicago	124-139
Golden State - Houston	99-93

Sainz: Dua të largohem nga Ferrari me titullin kampion për konstruktorë

Gara e Abu Dhabit në Formula 1, e fundit e këtij sezoni, është gara e fundit me makinën Ferrari edhe për pilotin spanjoll Carlos Sainz. Ai do të largohet nga "kokëkuqja" për t'i lënë vendin Lewis Hamiltonit. Gjithsesi, para se të

zbrësë nga makina ditën e diel, ai dëshiron ta mbyllë me nder këtë aventurë. "Kokëkuqja" synon titullin kampion për konstruktorë, teksa ndodhet 21 pikë pas rivalëve të McLarenit në renditje. "Të largohesha nga

Ferrari me titullin kampion për konstruktorë të fituar do të ishte gjithçka për mua. Do të ishte lamtumira perfekte pasi kam dhënë gjithçka në 4 vitet që kam garuar me këtë makinë", ka thënë Carlos Sainz. "Nuk dua të them se

do të jetë e pamundur, por do të përpiqemi deri në fund. Mendoj se do të jetë emocionuese dhe intensive, jo vetëm sepse do të jetë gara ime e fundit me Ferrarin", ka shtuar më tej piloti spanjoll. "Unë jam i kënaqur me

formën në të cilën arrita këtu. Do të jetë një betejë e ngushtë, jo vetëm mes nesh dhe McLarenit, pasi ka shumë faktorë që duhen marrë parasysh në një sezon kaq të vështirë mes skuadrave më të mira", ka përfunduar Sainzi.

SHKURT

Rahoveci arrin fitoren e dhjetë në dhjetë ndeshje

Kampioni në fuqi, Rahoveci, vazhdon me bilanc maksimal në Superligën e Kosovës në hendboll. Të enjten mbrëma në kryeqytet Rahoveci fitoi ndaj Prishtinës me rezultat 46:28. Ndeshja i takoi xhiros së dhjetë. Kjo ndeshje ishte shtyrë për shkak të sfidave evropiane të ekipit rahovecas. Në 15 minutat e parë në epërsi ishte Prishtina. Më pas mysafirët rritën ritmin dhe u shkëputën në rezultat. Në pjesën e dytë epërsia e Rahovecit ishte vazhdimisht bindëse. Mali Luzha shkëlqeu te Rahoveci me 12 gola. Nga gjashtë i kishin Arbios Mushkolaj e Alban Haziri, ndërsa katër i shënoi Granit Kadiri. Gola shënuan edhe nëntë lojtarë të tjerë të Rahovecit. Oltion Beshiri i realizoi 10 gola për Prishtinën. Nga katër i kishin Gent Bajrami e Edon Shaqiri. Rahoveci ka dhjetë fitore nga dhjetë ndeshje. Udhëheq në tabelë me 20 pikë. Prishtina është e katërta me 12 pikë. E pësoi humbjen e pestë.

Trajneri i Lazios: Hysaj bëri një ndeshje të shkëlqyer

Pas fitores 3-1 ndaj Napolit në Kupën e Italisë, trajneri i Lazios, Marco Baroni, vlerësoi ekipin e tij në një intervistë për "Mediaset": "Hysaj bëri një ndeshje të shkëlqyer. Nuk është në listë për kampionatin, por gjithmonë na ka ndihmuar. Sot doja ta shpërbleja dhe ai u përgjigj shumë mirë në fushë. Jam i kënaqur me interpretimin e skuadrës. Qëllimi ynë ishte të kalonim më tej dhe e arritëm, duke bërë një lojë të mirë". I pyetur për përparimin e Lazios dhe përmirësimet e mundshme, Baroni ka deklaruar: "Kemi një ekip që duhet të luajë futboll, sepse ka cilësi. Nga dita e parë lojtarët e kuptuan drejtimin që donim të ndiqnim dhe iu përkushtuan punës. Kjo është arsyeja pse çdo lojtar e konsideroj titullar. Ky grup, si në kampionat, ashtu edhe në Evropa Ligë, ka treguar gjithmonë cilësi. Procesi i rritjes po ecën shpejt, sepse kemi një ekip shumë të angazhuar. Sigurisht, kemi ende hapësirë për përmirësim dhe këtë duhet ta arrijmë".

Mourinho thumbon Guardiolen: Nuk dua të fitoj duke u marrë me 150 procese gjyqësore

Trajneri i Fenerbahçes, Jose Mourinho, i ka reaguar Pep Guardiolas lidhur me deklaratat e tij. Spanjollit ka thënë se Mourinho kishte fituar tre tituj, kurse ai gjashtë dhe se nuk ishin të njëjtë. Kurse Mourinho i ka reaguar, duke thënë se ai i fitoi me drejtësi dhe pastërti. "Pep Guardiola tha diçka dje... ai fitoi gjashtë trofe dhe unë fitova tre, por unë i fitova me drejtësi dhe pastërti. Nuk dua të fitoj duke u marrë me 150 procese gjyqësore. Nëse humb, e përgëzoj kundërshtarin tim", ka thënë Mourinho.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Ranori" Sh.P.K., Skenderaj në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Hulumtimin, Eksploatimin, Thërmimin dhe Seperimin e Rërës Kuarcore në ZK Klodernicë, Komuna e Skenderajt.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.01.2025 në ora 11:00 në objektin e SH.F.M.U. Faik Draga në fshatin Leqin, komuna Skenderaj, do të organizohet debat publik nga Kompania "Ranori" Sh.P.K., Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/8070162583?pwd=i0QlQDjDkARzojvRP3IVu8aZ1qoKFR.1>

Meeting ID: 807 016 2583

Passcode: R7ivfk





Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Ranori" Sh.P.K., Skenderaj, për Hulumtimin, Eksploatimin, Thërmimin dhe Seperimin e Rërës Kuarcore në ZK Klodernicë, Komuna e Skenderajt.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Lume's Details
Estetik & Depilim

 044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mirjeta Kryeziu shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

Halime Krasniqi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Pllumb Bajrami shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shfmu " 22 Deshmoret " Randobrave

- SADIJE SYLEJMANI;shpall te pavleshme deftesen e shkolles fillore ;bislam imeri ish shkolla fillore Aziz sylejmani.

- URIM IBISHI;shpall te pavleshme diplomen e SHMLT ARKITEKT SINANI

- Erik Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" dhe certifikatën e maturës.

- Vera Jaha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

